



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

3678/1
Nr. ___ Prot.

Tiranë, më 29/05/2023

URDHËR

Nr. 365, datë 29/05/2023

“PËR PEZULLIMIN E PËRKOHSHËM TË LICENCËS SË NOTERES MARINELA BODE”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të gërmës “a”, të pikës 1, të nenit 18, të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar,

KONSTATOJ:

Noteria Marinela Bode, e cila e ka fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit të noterit bazuar në Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 270 datë 13.06.2012, në Rrethin Gjyqësor Tiranë, nëpërmjet shkresës me nr. M-206 prot., datë 02.05.2023, ka paraqitur kërkesën për pezullimin e licencës së noterit, me një kohëzgjatje 1 (një) vjeçare, për arsye shëndetësore.

Në kërkesën e paraqitur noteria parashtron se: *“Bazuar në nenin 18, pika 1, gërma “a” e ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë” i ndryshuar, parashikon se: Pezullimi i përkohshëm i licencës së noterit me kërkesën e tij: Noteri ka të drejtë të kërkojë që licenca e tij të pezullohet përkohsisht, për arsyet e mëposhtme: a) për shkaqe shëndetësore, të provuara nga vërtetimi i gjendjes shëndetësore, sipas legjislacionit në fuqi... Nëpërmjet kësaj kërkesë, kërkoj pezullimin e përkohshëm të licencës së noterit për një periudhë kohore 1 vit, në varësi të gjendjes shëndetësore.”*

Bazuar në pikën 3, të nenit 18, të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë” i ndryshuar, ku parashikohet se *“Ministri i Drejtësisë vendos për pranimin ose refuzimin e argumentuar të kërkesës për pezullimin e përkohshëm të licencës së noterit, duke marrë në konsideratë edhe mendimin e Dhomës”,* Dhoma Kombëtare e Noterisë, me shkresën nr. M-206/1 prot., datë 15.05.2023, shpreh miratimin për pezullimin e përkohshëm të veprimtarisë noteriale të noterës Marinela Bode për periudhën e sipërcituar.

Për sa më sipër, vlerësojmë se noteria Marinela Bode gjendet përpara parashikimeve të nenit 18, pika 1 sipërcituar, pra përpara rastit kur noteri ka të drejtë të kërkojë që licenca e tij të pezullohet përkohsisht, për shkaqe shëndetësore, të provuara nga vërtetimi i gjendjes shëndetësore, sipas legjislacionit në fuqi,

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë

14.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, të gërmës "a", pikës 1, të nenit 18, të ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Pezullimin e përkohshëm të licencës së ushtrimit të profesionit të noteres Marinela Bode, anëtare e Degës Vendore të Noterisë Tiranë, për periudhën kohore 1 vjeçare nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, për arsye shëndetësore.
2. Caktimin e një noteri për administrimin e arkivës noteriale të noteres Marinela Bode, deri në përfundimin e afatit të pezullimit të licencës sipas parashikimeve në pikën 1 të këtij urdhri.
3. Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:
 - a.) Përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë;
 - b.) Një noter i caktuar nga Dega Vendore e Noterisë Tiranë.
4. Dega Vendore e Noterisë Tiranë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, brenda 7 ditëve nga marrja dijeni e këtij urdhri, të përcjellë emrin e noterit për marrjen në dorëzim të arkivit, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar.
5. Lënien në ruajtje të vulave respektive, vulën e thatë dhe vulën e njomë, të noteres Marinela Bode, deri në përfundimin e afatit të pezullimit të licencës, në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë;
6. Të njoftohen menjëherë me përmbajtjen e këtij urdhri institucionet e linjës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, gjykatat e shkallës së parë dhe Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Bankat e nivelit të dytë.
7. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë.
8. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë, Dega Vendore e Noterisë Tiranë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, për marrjen e masave të nevojshme për zbatimin dhe njoftimin e këtij Urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI


Ulsi Manja

